FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT: Informacion për pacientin

RINGER LACTATE

Tretësirë për perfuzion – (0.135 g + 0.2 g + 3 g + 1.56 g) / 500 ml

(Klorur kalçiumi dihidrat, Klorur kaliumi, Klorur natriumi, Laktat natriumi)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Ringer lactate dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Ringer lactate
3. Si ta merrni Ringer lactate
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Ringer lactate
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË RINGER LACTATE DHE PËRSE PËRDORET

Ringer lactate është një produkt farmaceutik që ka lëndë aktive: klorurin e kalçiumit dihidrat, klorurin e natriumit, klorurin e kaliumit dhe laktatin e natriumit. Këto lëndë hyjnë në grupin e madh të elektrolitëve.

Perfuzioni i Ringer Lactate përdoret për të rregulluar balancën acido-bazike të gjakut. Elektrolitet merren me qëllim arritjen ose ruajtjen e një situate osmotike normale në lëngjet qelizore dhe në ato jashtëqelizore.

2. PËRPARA SE TË MERRNI RINGER LACTATE

Mos merrni Ringer lactate:

- nëse jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj ndonjërit prej përbërësve të barit pasi mund të shfaqen reaksione alergjike;
- nëse jeni në gjendje hiperhidratimi;
- tek të porsalindurit (≤ 28 ditë), sepse ky bar i administruar njëkohësisht me ceftriaksonin, edhe nëse përdoren linja të veçanta infuzioni, shfaq një risk fatal të precipitimit të kripërave të kalçiumit me ceftriaksonin në sistemin e qarkullimit të gjakut të të porsalindurit;
- nëse jeni duke marrë terapi me digitalikë;
- në rast alkaloze metabolike;
- në rast acidoze laktike.

Tregoni kujdes të veçantë me Ringer lactate

Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Ringer lactate.

Tretësira për perfuzion e Ringer lactate duhet përdorur me kujdes të veçantë, ose shmangur, në pacientë me:

- dëmtime kongjestive të zemrës;
- insufiçiencë renale;
- hiperkalemi;
- hiperkalçemi;
- hiperkloremi;
- hipernatremi;
- hipertension;
- hipervolemi;
- alkalozë respiratore ose metabolike;
- cirrozë ascitike;
- acidozë metabolike të rëndë.

Duke qenë se përmban kripëra të natriumit, duhet përdorur me kujdes tek pacientët me: edema periferike ose pulmonare, dëmtime pulmonare, pre-eklampsi, aldosteronizëm ose në kushte të tjera që shoqërohen me mbajtjen e natriumit.
Tretësirat që përmbajnë jone laktat duhet të përdoren me kujdes të madh tek pacientët me alkalozë respiratore ose metabolike. Administrimi i joneve laktat duhet të bëhet me shumë kujdes veçanërisht në rastet e insufiçiencës hepatike sepse në këtë rast ndodh një rritje e përqëndrimit të këtyre joneve për shkak të shfrytëzimit jo të plotë.
Kloruri i kalçiumit mund të jetë i dëmshëm nëse injektohet në indet e trupit. Për këtë tretësira nuk duhet të jepet duke e administruar në muskul (injektim intramuskular) dhe duhet të tregohet shumë kujdes që ajo të mos dalë jashtë venës.

Marrja e barnave të tjera

Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Për të minimizuar rrezikun e papajtueshmërive të mundshme që mund të shfaqen nga përzierja e tretësirës për perfuzion Ringer lactate me tretësira të tjera, duhet vërejtur me kujdes përzierja përfundimtare para injektimit dhe periodikisht gjatë përdorimit për mundësinë e ndonjë turbullire ose fundërrese.
Është veçanërisht e rëndësishme që të jeni të kujdesshëm për shkak se:

- prania e laktatit të natriumit në përbërje të Ringer lactate pengon fundërrimin e karbonatit të kalçiumit, sepse kalçiumi në trajtën e laktatit është i tretshëm në ujë;
- barnat që përmbajnë oksalate, fosfate, ose karbonate dhe bikarbonate mund të shkaktojnë fundërrime pasi përzihen me perfuzionin e Ringer lactate;
- administrimi i njëkohshëm i Ringer lactate me ceftriaksonin tek të porsalindurit, edhe pse në linja të veçanta infuzioni, shfaq një risk fatal të fundërrimit të kripërave të kalçiumit me ceftriaksonin në sistemin e qarkullimit të gjakut të të porsalindurit.

Ndërveprime të lidhura me praninë e natriumit:

- kortikosteroidë, që janë të lidhur me mbajtjen e natriumit dhe ujit (me edema dhe hipertension).

Ndërveprime të lidhura me praninë e kaliumit:
- diuretikët kalium-kursyes (amilorid, spironolakton, triamteren, vetëm ose së bashku);
- ACE - inhibitorët (ACEi) dhe antagonistët e receptorëve të angiotenzinës II;
- takrolimus, ciklosporinë,
të cilët rrisin përqëndrimin e kaliumit në plazmë dhe mund të çojnë në hiperkalemi të dukshme, sidomos në rastet e pamjaftueshmërisë së veshkave ku rritet efekti hiperkalemik.

Ndërveprime të lidhura me praninë e kalçiumit:
- glikozidet digitalikë (digitalikët kardiotonikë), efektet e të cilave rriten nga prania e kalçiumit dhe mund të çojnë në aritmi të rënda apo fatale të zemrës;
- diuretikët tiazidikë apo vitamina D.

Ndërveprime të lidhura me praninë e laktatit (i cili metabolizohet në bikarbonat):
Kujdes këshillohet kur administrohet Ringer lactate te pacientët e trajtuar me barna për të cilat eliminimi me anë të veshkave është i varur nga pH. Për shkak të veprimit alkalinizues të laktatit (formimi i bikarbonateve), Ringer lactate mund të ndërhyjë në eliminim.
- Eliminimi nga veshkat i barnave acidë si: salicilatet, barbituratet dhe litiumi mund të rritet për shkak të alkalinizimit të urinës nga bikarbonatet që rrjedhin nga metabolizmi i laktatit.
- Eliminimi nga veshkat i barnave alkalinë, të tillë si simpatomimetikët (p.sh. efedrina, pseudoefedrina) dhe stimuluesve (p.sh. deksamfetaminë sulfat, fenfluraminë klorhidrat) mund të zvogëlohet.

Marrja e Ringer lactate me ushqim dhe pije
Marrja e Ringer lactate nuk ndikohet nga marrja e ushqimeve dhe pijeve.

Shtatzënia dhe ushqimi me gji
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar.

Perfuzioni i Ringer lactate mund të jepet gjatë shtatzënisë dhe ushqimit me gji, por duhet të përdoret me kujdes për shkak të një toksiciteti të mundshëm.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Ky produkt mjekësor nuk ka ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe për të përdorur makineri.

3. SI TA MERRNI RINGER LACTATE

Mjeku juaj do t'ju informojë për sasinë e Ringer lactate që duhet të merrni dhe kur ta merrni atë. Është e rëndësishme që të ndiqni udhëzimet e mjekut tuaj me përpikmëri.

Ringer lactate – tretësirë për perfuzion aplikohet në rrugë parenterale (administrim intravenoz).

Dozimi: 20 – 30 ml / kg peshë. Për zëvendësimin e lëngjeve perfuzionohen në venë deri në 3,000 ml tretësirë Ringer lactate.

Në qoftë se keni marrë më shumë Ringer lactate

Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë mbidozim, gjithsesi njoftoni menjëherë mjekun nëse mendoni se keni marrë një dozë më të lartë se ajo që duhet.

Rrallë ndodhin efekte anësore nga mbidozimi me Ringer lactate.

Mbidozimi mund të shfaqet me: hiperhidratim, kongjestion venoz, edema pulmonare dhe çrregullime të balancës acido-bazike.

Administrimet e zgjatura me Ringer lactate mund të shkaktojnë alkalozë metabolike, hiperkalçemi, hiperkalemi.

Trajtimi i mbidozimit: Ndërprerja e perfuzionit, marrja e diuretikëve me monitorim të vazhdueshëm të elektrolitëve në gjak dhe korrigjimi i ekuilibrit acido-bazik.

Në qoftë se harroni të merrni Ringer lactate

Ky bar do ju administrohet në spital, ndaj nuk ka shumë gjasa që të ndodhë harresë, gjithsesi nuk duhet marrë dozë e dyfishtë (ose më e lartë), për të kompensuar dozën e harruar.

Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Gjatë përdorimit të perfuzionit të Ringer lactate mund të shfaqet hiperkloremia.

Efektet anësore të kripërave të natriumit vijnë si rezultat i imbalancës elektrolitike që vjen nga shtimi i natriumit. Kjo çon në akumulimin e lëngjeve jashtëqelizore, që mund të çojë në edemë pulmonare dhe periferike. Hipernatremia shoqërohet zakonisht me mbajtjen e ujit brendaqelizor. Efekti më i rëndë i hipernatremisë është dehidrimi i trurit, që shkakton përgjumje dhe konfuzion me pasojë konvulsione, komë, depresion respirator dhe vdekje. Simptoma të tjera përfshijnë: etjen, reduktimin e pështymës dhe lotimit, temperaturë, takikardi, hipertension ose hipotension, dobësi, irritueshmëri, dridhje muskulore dhe rigiditet.

Mund të shfaqen reaksione alergjike të tilla si: urtikarie të lokalizuara ose të gjeneralizuara, edema laringeale dhe faciale, kollë, teshtima dhe vështirësi në frymëmarrje. Këto efekte janë më të shpeshta gjatë shtatzënisë.

Reaksione mund të shfaqen edhe nga teknika e administrimit duke përfshirë: temperaturë, infeksione në vendin e injektimit, tromboza ose tromboflebite, hipervolemi, etj.

5. SI TA RUANI RINGER LACTATE

Mbajeni larg fëmijëve!

Mos e përdorni tretësirën për perfuzion të Ringer lactate pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.

Ruajeni nën temperaturën 25°C!

Ruajeni në paketimin origjinal!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Ringer lactate – Tretësirë për perfuzion

Lëndët vepruese janë: klorur kalçiumi dihidrat, klorur kaliumi, klorur natriumi dhe laktat natriumi.

Çdo shishe qelqi ose qese plastike 500 ml përmban: 0.135 g klorur kalçiumi dihidrat, 0.2 g klorur kaliumi, 3 g klorur natriumi dhe 1.56 g laktat natriumi.

Përbërës të tjerë: ujë për injeksion.

Përmbajtja e paketimit

Shishe qelqi ose qese plastike 500 ml.

Mbajtësi i autorizimit për tregtim dhe prodhuesi:
PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - Shqipëri

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Maj 2013.